



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

V UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

SENATI AKADEMIK

Nr. 1901 Prot

Shkodër, më 27. 05.2025

V E N D I M

Nr. 161, datë 27. 05.2025

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN "MBI
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SENATIT AKADEMIK TË
UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Neni 3 pika 4, germa *a*; Statutin e USH-së, Neni 5, pika 1, Neni 17, pika 6, germa *r*; Rregullores "Mbi organizimin dhe funksionimin e Senatit Akademik të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 27.05.2025,

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimet në Rregulloren "Mbi organizimin dhe funksionimin e Senatit Akademik të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" (sipas materialit bashkëlidhur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. dr. Tomir GJERAJ





R R E G U L L O R E

"MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

I. Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Senati Akademik (SA) është organi kolegjal akademik më i lartë i drejtimit të Universitetit të Shkodrës, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij, garantimin e autonomisë së USH-së, lirisë akademike, të drejtave të stafit dhe të studentëve të USH-së.

Neni 2

Funksionimi i Senatit bazohet në Ligjin Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë*", në Ligjin Nr.8480, datë 27.5.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*", Statutin e USH-së dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi.

Neni 3

Senati përcakton politikat e zhvillimit të USH-së, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, të çështjeve administrative dhe financiare, si dhe vlerëson efikasitetin e tyre.

II. Organizimi i Senatit Akademik

Neni 4

Senati Akademik përbëhet nga kryetari, sekretari, anëtarë të zgjedhur të personelit të brendshëm akademik dhe përfaqësues të zgjedhur nga studentët.

Neni 5

Anëtarët e Senatit Akademik të USH-së organizohen në katër komisione të përhershme: komisioni i Kurrikulave; komisioni i Kërkimit Shkencor dhe i Botimeve; komisioni i Statutit, Rregulloreve dhe Disiplinës; komisioni i Ekonomisë dhe Burimeve Njerëzore; komisioni i Marrëdhënieve me Jashtë.



Neni 6

Kryetari

1. Kryetari i Senatit akademik është Rektori i Universitetit.
2. Kryetari i Senatit drejton mbledhjen e Senatit, garanton zbatimin e ligjit dhe raporton para SA-së.
3. Kryetari i paraqet SA-së planin strategjik të zhvillimit të USH-së.
4. Kryetari propozon planin vjetor të punës së SA-së për çështjet kryesore që janë për t'u miratuar gjatë vitit nga SA, si dhe për çështjet e propozuara nga anëtarët ose komisionet e përhershme të SA-së, i cili miratohet nga SA.
5. Kryetari mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe në rastet kur situata e përligj këtë veprim. Në këto raste duhet të merret një vendim i arsyetuar, i cili do të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.
6. Kryetari i propozon SA-së heqjen e mandatit të anëtarit të SA-së kur mandati i tij merr fund, sipas përcaktimeve të bëra në Statutin e USH-së.

Neni 7

Sekretari

1. Sekretari zgjidhet nga propozimet e anëtarëve të SA-së dhe me votim të fshehtë nga shumica e gjithë anëtarëve të SA-së.
2. Sekretari bën njoftimin për datën, orën e mbledhjes së radhës dhe rendin e ditës të paraqitur nga Kryetari i Senatit.
3. Sekretari përgatit dosjen me materialet e rendit të ditës të vlerësuara nga Komisionet e përhershme të Senatit dhe të paraqitura për t'u përfshirë në rendin e ditës nga Kryetari, të cilat ua shpërndan anëtarëve të Senatit në mënyrë elektronike para mbledhjes dhe të printuar në mbledhje, sipas rastit, asistuar nga Drejtorja ose sektori përkatës.
4. Sekretari zbardh vendimet e Senatit mbi bazën e procesverbalit të mbajtur në mbledhje dhe draftvendimeve që shoqërojnë çdo çështje të rendit të ditës, të sjellë nga Drejtorja ose sektori përkatës për t'u marrë vendim. Ai, më pas, përpilon relacionin mbi mbledhjen e Senatit.
5. Sekretari mban listëprezencën e anëtarëve të SA-së në mbledhje, në të cilën nënshkruan çdo anëtar pjesëmarrës në mbledhje, dhe pas përfundimit të saj, harton listëpagesën e pjesëmarrjes së anëtarëve të SA-së për çdo mbledhje, të cilën, pasi e firmos, ia dërgon për firmë Kryetarit të SA-së, dhe pas protokollimit, ia përcjell për zbatim drejtorisë Ekonomike të USH-së.

6. Sekretari mban listëprezencën e pjesëmarrjes në mbledhje dhe të pagesës së anëtarëve të SA-së dhe ia paraqet për çdo mbledhje kryetarit të SA-së. Pjesëmarrja e anëtarëve të Senatit është me prani fizike dhe online, për arsye të justifikuara akademike. Anëtarët e Senatit Akademik duhet të jenë të pranishëm në mbledhje në datën dhe orën e njoftuar. Përgjatimisht, për shkaqe objektive, pjesëmarrja në mbledhje për efekt vendimarrjeje dhe pagese, do të lejohet dhe pranohet deri përpara se të ketë filluar procedura e votimit për çështjen e pikës së parë të rendit të ditës.

Neni 8

Zëvendësimi i përkohshëm i kryetarit dhe i sekretarit të SA-së

1. Në rast mungese, Kryetari dhe Sekretari i Senatit, secili prej tyre, delegojnë përkohësisht, nga një anëtar të SA-së, të cilët janë përfaqësues të stafit akademik.

Neni 9

Anëtarët e Senatit

1. Anëtarët e Senatit janë pedagogë me kohë të plotë në USH dhe i përkasin kategorisë “Profesor” ose që kanë gradën shkencore “Doktor” (“PhD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në mungesë të kandidaturave me këtë titull dhe për efekt përfaqësimi, kategoria e tyre mund të zbresë, sipas përcaktimeve të bëra në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Numri i anëtarëve të Senatit nga radhët e stafit akademik që vjen nga çdo njësi kryesore, përcaktohet nga vendimi i SA-së pas shpalljes së zgjedhjeve të reja, sipas formulës të përcaktuar në Statutin e USH-së. Anëtarë të Senatit akademik janë edhe përfaqësuesit që vijnë nga radhët e studentëve, numri i të cilëve përcaktohet në Statutin e USH-së.
3. Anëtarët e Senatit akademik zgjidhen sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

Neni 10

Komisionet e Senatit

1. Për të lehtësuar funksionimin e brendshëm të Senatit, krijohen komisionet e përhershme të Senatit, që bëjnë vlerësimin paraprak të çështjeve të propozuara për t’u shqyrtuar në mbledhjen e radhës së Senatit. Komisionet zgjedhin kryetarin e tyre. Raportet e tyre duhen të firmosen nga të gjithë anëtarët e komisionit duke shprehur qëndrimin personal të tyre.

2. Në komisionet e përhershme të Senatit angazhohen të gjithë anëtarët e Senatit. Anëtarët për këto komisione vetëproponohen dhe miratohen nga Senati Akademik i USH-së.
3. Për probleme specifike krijohen komisione të përkohshme; përbërja, objekti, afati kohor dhe mandati i të cilëve përcaktohen në vendimin përkatës të Senatit.
4. Komisionet e ngritura nga SA kanë të drejtë të marrin specialistë për asistencë.

III. Organizimi i mbledhjeve

Neni 11

Thirrja e mbledhjeve

1. Kryetari vendos për datën dhe kohën e mbledhjeve të radhës, përveç rasteve kur vetë Senati ka vendosur ndryshe. Çdo ndryshim për datën dhe kohën e vendosur për mbledhje, i komunikohet çdo anëtar të Senatit, në mënyrë që ata të njihen me këto ndryshime.
2. Senati mbledhet në seanca të zakonshme, një herë në muaj, në përputhje me programin e punës të publikuar në fillim të çdo viti akademik.
3. Senati mund të mbledhet edhe në seanca të jashtëzakonshme, me iniciativën e kryetarit të Senatit ose me kërkesën e 1/3 (një të tretës) së anëtarëve të tij, duke përcaktuar me shkrim çështjet, për të cilat thirret kjo mbledhje.
4. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve të SA-së bëhen të paktën 5 ditë para datës së thirrjes së mbledhjes.
5. Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të shoqërohet me rendin e ditës.
6. Mbledhja e thirrur në mënyrë të rregullt e Senatit të USH-së është e vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij. Në rast të kundërt, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të paktën 24 orë pas së parës. Në këtë rast mbledhja është e vlefshme në qoftë se janë të pranishëm së paku gjysma e anëtarëve të Senatit.
7. Kur nuk respektohen procedurat e parashikuara për thirrjen dhe zhvillimin e mbledhjes së Senatit, mbledhja është e vlefshme, vetëm në rastin, kur në të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Senatit, të cilët, paraprakisht, miratojnë zhvillimin e mbledhjes.
8. Mbledhjet e Senatit si rregull janë të hapura, me përjashtim kur përcaktohet ndryshe në aktet nënligjore në fuqi.

Neni 12

Rendi i ditës

1. Kryetari i Senatit vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje.
2. Rendi i ditës duhet të përfshijë ato çështje që janë në kompetencë të Senatit të cilat janë propozuar nga anëtarët e Senatit dhe nga Rektorati i USH-së.

3. Kërkesa për ta futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim deri 15 ditë pas datës së mbledhjes së fundit të Senatit, shoqëruar me bazën ligjore justifikuese të çështjes që kërkohet të trajtohet në atë mbledhje. Kërkesa i dërgohet Sekretarit të Senatit, i cili ia përcjell Kryetarit të Senatit, e më pas kërkesa me materialin shoqërues, i kalohet komisionit përkatës të përhershëm të Senatit.
4. Komisioni i përhershëm i dërgon Kryetarit të Senatit brenda 5 (pesë) ditëve vlerësimin e tij me shkrim për çështjet e propozuara për t'u trajtuar në mbledhjen e radhës. Në rast se komisioni nuk bie dakord me materialin e një çështjeje të caktuar, ai ka të drejtë, që t'ia kthejë për ripunim propozuesve të çështjes. Koha e ripunimit është deri 3 (tre) ditë. Këtë të drejtë komisioni e ka vetëm një herë. Nëse edhe pas ripunimit komisioni ka vërejtje serioze për materialin, ai është i detyruar ta përcjellë atë në Senat brenda tri ditëve dhe të shprehë atje me shkrim kundërshtimet e veta.
5. Njoftimi për mbledhjen e Senatit u dërgohet anëtarëve të tij, pasi janë shprehur komisionet, jo më pak se pesë ditë nga data e zhvillimit të mbledhjes.

Neni 13

Zhvillimi i mbledhjeve

1. Çdo Senator ka të drejtë të diskutojë vetëm njëherë për një çështje dhe jo më shumë se 5 minuta.
2. Çdo anëtar i SA-së ka të drejtë të replikojë kur i përmendet emri i tij.

Neni 14

Forma e votimit

1. Vendimet merren me votim të hapur.
2. Vendimet që përmbajnë vlerësime mbi etikën, cilësinë e një individi ose propozime të miratuara nga Senati merren me votim të fshehtë.
3. Anëtarët e Senatit që kanë ndonjë pengesë ligjore nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë diskutimeve dhe votimit (sipas përcaktimeve në aktet nënligjore në fuqi).

Neni 15

Shumica e nevojshme për të marrë vendime

1. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të SA-së që marrin pjesë në mbledhje, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, në akte ligjore dhe normative.
2. Për rastet kur kërkohen ndryshime të Statutit të USH-së apo të Rregulloreve të tij, vendimet merren me jo më pak se 2/3 e votave "pro" të anëtarëve të Senatit.

3. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë dhe votimi nuk ka qenë i fshehtë, vota e Kryetarit është vendimtare.
4. Në rast se votimi bëhet i fshehtë dhe votat janë të barabarta, do të kryhet një votim i dytë. Në qoftë se edhe në votimin e dytë ka barazi të votave, vendimi do të shtyhet për mbledhjen tjetër.
5. Vendimet e Senatit nënshkruhen nga Kryetari i tij dhe publikohen në faqen zyrtare të USH-së, pesë ditë pas miratimit të tyre. Vendimet hartohen në tri kopje, ku njëra prej të cilave, arkivohet në arshivën e USH-së, tjetra arkivohet në dosjen e SA-së, dhe e fundit i dërgohet njësive përkatëse për zbatim.
6. Çdo anëtar i Senatit ka të drejtë të bëjë ankime në gjykatën kompetente kundër vendimeve të marra nga ky organ, kur çmon se vendimi është i kundërligjshëm, brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 16

Procesverbali dhe relacioni i mbledhjes

1. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku shkruhet data, vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, rendi i ditës, çështjet e diskutuara mbi pikat e rendit të ditës, forma dhe rezultati i votimeve dhe vendimet.
2. Procesverbali mbahet nga asistenti i Rektorit dhe në fund firmoset edhe nga Sekretari dhe Kryetari i SA-së. Çdo anëtar pjesëmarrës i Senatit Akademik, mund të firmosë me dëshirë në procesverbalin e mbledhjes.
3. Relacioni përgatitet mbi bazën e vendimeve të zbardhura dhe procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e SA-së. Relacioni nënshkruhet në dy kopje nga Sekretari dhe Kryetari i SA-së.
4. Anëtarët e Senatit mund të kërkojnë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsyeja e votimit kundër për vendimin e marrë nga Senati.
5. Procesverbali, një kopje origjinale e vendimeve dhe relacionit të mbledhjeve të SA-së, mbahen në zyrën e asistentit të Rektorit.

Neni 17

1. Senati i USH-së funksionon dhe ka fuqi ligjore vendimmarrëse brenda hapësirës kohore të legjislaturës, për të cilën është zgjedhur. Mandati i Senatit Akademik përfundon me mbledhjen e parë të Senatit të ri.



Neni 18
Dispozita e fundit

1. Kjo rregullore mund të ndryshohet me kërkesë të Kryetarit të Senatit ose të më shumë se 1/3 (një e treta) e anëtarëve të tij dhe me miratimin e më shumë se gjysmës së anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
2. Çdo ndryshim i rregullores i kërkuar duhet të vlerësohet dhe të justifikohet nga ana ligjore nga Komisioni i përhershëm i Statutit, Rregulloreve dhe Disiplinës së SA-së.

Neni 19
Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë me marrjen e vendimit të miratimit nga Senati Akademik i USH-së dhe firmosjes nga Kryetari i tij.

KRYETARI I SENATIT

Prof. dr. Tonin GJERAJ

